

VENDIM
Nr. 25, datë 16.1.2019

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT
TË SHTETIT PËR VITIN 2019, PËR PAGESËN E QENDRËS NDËRKOMBËTARE
PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE TË INVESTIMEVE (ICSID)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, i shtohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019, si pagesë për detyrimet që rrjedhin ndaj Qendrës Ndërkombëtare për zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID), lidhur me arbitrazhin ndërkombëtar ARB/14/26, ndërmjet shoqërisë “Albaniabeg Ambient” sh.p.k., Angelo Novelli, “*Costruzioni*”, s.r.l., kundër Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama